



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT, KADASTRES DHE INVESTIMEVE
PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Vau Dejes, më 09.07.2024

Projekt – Vendim
Nr. 08 Date : 09.07.2024

Për një shtese në VKB Nr. 41 date 27.06.2022 “Per Miratimin e Rregullores së Brëndshme për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike” si dhe për hapjen e disa vend parkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A. Temal, Bashkia Vau Dejës .

Në mbështetje të ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ndryshuar. Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, Ligjit nr 107/2014 “Për Planifikimin Dhe Zhvillimin Të Territorit” i ndryshuar, Ligji 9632 date 30.10.2006 i ndryshuar, VKM nr 1096 date 28.12.2015 “ Per miratimin e rregullave dhe Proçedurave per perdorimin dhe menaxhimin e hapësires publike, VKB Nr. 71. Date 26.11.2020 “ Per Miratimin e Paketës Fiskale Bashkia Vau Dejes , ndryshuar, si dhe ne zbatim te Urdherit te Kryetarit te Bashkise Nr. 404 date 07.06.2024 me Prot 3669/1 “Per ngritjen e grupit të punes për verifikimin e problematikes dhe disiplinimin e parkingjeve publike në Nj.A. Temal, si dhe ne Relacionin e paraqitur nga grupi I Punes me Nr. 3669/2 Prot date 14.06.2024:

PROPOZOJME

1. Këshillit Bashkiak Vau Dejes të miratojë kete projekt vendim për një shtese në VKB Nr. 41 date 27.06.2022 “Rregulloren e Brëndshme për shfrytëzimin e hapësirave publike“, bashkëlidhur rregullorja. Konkretisht :

Pas nenit 7 shtohet:

Neni 7.1:

Shfrytëzimi i hapësirave publike për vendparkime të menaxhuar nga Bashkia.

- a. Strukturat pranë Bashkise studiojnë dhe propozojnë hapësirat e duhura për vendparkime të reja për automjete duke përcaktuar terrenin, planvendosjen dhe mënyren e menaxhimit.
- b. Keshilli Bashkiak miraton vendin dhe planimetritë të cilat propozohen nga kryetari i Bashkisë.
- c. Keshilli Bashkiak miraton mënyren e menaxhimit të vendparkimeve duke nderthurur mënyra të ndryshme si:
 - i. Parking publik pa pagesë.
 - ii. Parking publik sezonal me bileta.
 - iii. Parking publik me kontrate vjetore për subjekte apo biznese të interesuar.
- d. Vëndparkimet publike pa pagesë do të menxhohen nga Njesia Administartive përkatëse në Bashkëpunim me Bashkinë Vau Dejës.
- e. Vendparkimet publike sezonale me bilete do të menaxhohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike
- f. Vendparkimet publike me kontratë vjetore i nënshtrohen proçedures se percaktuar nga neni 8 e ne vijim i VKB Nr. 41 date 27.06.2022 “Rregulloren e Brëndshme per shfrytezimin e hapësirave publike „

2. Këshillit Bashkiak Vau Dejës të miratojë hapjen e disa vendparkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A. Temal, Bashkia Vau Dejës, sipas hartës bashkëlidhur këtij propozimi dhe sipas projekteve të hartuara nga grupi punes ne zbatim te Urdherit te Kryetarit te Bashkise Nr. 404 date 07.06.2024 me Prot 3669/1 “Per ngritjen e grupit të punes per verifikimin e problematikes dhe disiplinimin e parkingjeve publike ne Nj.A. Temal bashkelidhur këtij projekt vendimi.

Ky propozim për ndryshim vjen si nevojë urgjente për ndërhyrje kryesisht në Nj.A. Temal, fshati Koman me qëllim menaxhimin sa me efikas te fluksit turistik gjate sezonit veror por edhe gjate gjithë vitit.

Gjithashtu Kjo rregullore do ti shërbeje Bashkisë Vau Dejës të ktheje ne efikasitet dhe menaxhojë hapësirat publike ne fshatin Koman, jo vetem per trafikun qe sjell turizmi por qe tu japë mundësi bizneseve që janë të interesuar për vendparkime të personalizuar , si dhe banoreve te zones te cilet jetojne dhe po kthehen per te investuar ne vendin e tyre.

Për zbatimin e këtij vendimi do të jenë të ngarkuara: Drejtoria e Planifikimit të Territorit Dhe Investimeve Publike, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Policia Bashkiake.

Juriste: Dorina Lekaj 
Drejtorja e Planifikimit Territorit, Kadastres dhe Investimeve Publike

Drejtore: Ana Shurdha 
Drejtorja e Planifikimit Territorit, Kadastres dhe Investimeve Publike

**KRYETARI
KRISTIAN SHKRELI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT, KADASTRES DHE INVESTIMEVE
PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Vau Dejes, më 07.2024

Lenda: *Relacion sqarues lidhur me Projekt Propozimin Për një shtese në VKB Nr. 41 date 27.06.2022 “Per Miratimin e Rregullores së Brëndshme për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike” si dhe për hapjen e disa vend parkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A. Temal, Bashkia Vau Dejës .*

Në mbështetje të ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ndryshuar. Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, Ligjit nr 107/2014 “Për Planifikimin Dhe Zhvillimin Të Territorit” i ndryshuar, Ligji 9632 date 30.10.2006 i ndryshuar, VKM nr 1096 date 28.12.2015 “ Per miratimin e rregullave dhe Proçedurave per perdorimin dhe menaxhimin e hapësires publike, VKB Nr. 71. Date 26.11.2020 “ Per Miratimin e Paketës Fiskale Bashkia Vau Dejes , ndryshuar, si dhe ne zbatim te Urdherit te Kryetarit te Bashkise Nr. 404 date 07.06.2024 me Prot 3669/1 “Per ngritjen e grupit të punes për verifikimin e problematikes dhe disiplinimin e parkingjeve publike në Nj.A. Temal, si dhe ne Relacionin e paraqitur nga grupi i Punes me Nr. 3669/2 Prot date 14.06.2024 është vlerësuar e domosdoshme që krahas hapjes së Vendparkimeve në fshatin Koman të bëhet një ndërhyrje edhe në VKB Nr. 41 date 27.06.2022 “Per Miratimin e Rregullores së Brëndshme për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike”, konkretisht për një shtesë lidhur me menaxhimin e vendparkimeve sezonale me bileta dhe vendparkimeve pa pagese per banoret e këtij fshati te cilat do te menaxhohen nga Njesia Administrative Temal.

Ky propozim për ndryshim vjen si nevojë urgjente për ndërhyrje kryesisht në Nj.A. Temal, fshati Koman me qëllim menaxhimin sa me efikas te fluksit turistik gjate sezonit veror por edhe gjate gjithë vitit.

Gjithashtu Kjo rregullore do ti shërbeje Bashkisë Vau Dejës të ktheje ne efikasitet dhe menaxhojë hapësirat publike ne fshatin Koman, jo vetem per trafikun qe sjell turizmi por qe tu japë mundësi bizneseve që janë të interesuar për vendparkime të personalizuara , si dhe banoreve te zones te cilet jetojne dhe po kthehen per te investuar ne vendin e tyre.

Sa me siper sqarojme Keshillin Bashkiak sei vetmi ndryshim qe dote behet ne VKB Nr. 41 date 27.06.2022 “Per Miratimin e Rregullores së Brëndshme për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike” eshte te shtohet nje dispozite, konkretisht si me poshte:

Pas nenit 7 shtohet:

Neni 7.1:

Shfrytëzimi i hapësirave publike për vendparkime të menaxhuar nga Bashkia.

- a. Strukturat pranë Bashkise studiojnë dhe propozojnë hapësirat e duhura për vendparkime të reja për automjete duke përcaktuar terrenin, planvendosjen dhe mënyren e menaxhimit.
- b. Keshilli Bashkiak miraton vendin dhe planimetritë të cilat propozohen nga kryetari i Bashkisë.
- c. Keshilli Bashkiak miraton mënyren e menagjimit të vendparkimeve duke nderthurur mënyra të ndryshme si:
 - i. Parking publik pa pagesë.
 - ii. Parking publik sezonal me bileta.

- iii. Parking publik me kontrate vjetore për subjekte apo biznese të interesuar.
 - d. Vëndparkimet publike pa pagesë do të menxhohen nga Njesia Administartive përkatëse në Bashkëpunim me Bashkinë Vau Dejës.
 - e. Vëndparkimet publike sezonale me bilete do të menaxhohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike
 - f. Vëndparkimet publike me kontratë vjetore i nënshtrohen proçedures se percaktuar nga neni 8 e ne vijim i VKB Nr. 41 date 27.06.2022 *“Rregulloren e Brëndshme për shfrytëzimin e hapësirave publike”*,
1. Këshillit Bashkiak Vau Dejës të miratojë hapjen e disa vëndparkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A. Temal, Bashkia Vau Dejës, sipas hartës bashkëlidhur këtij propozimi dhe sipas projekteve të hartuara nga grupi punes ne zbatim te Urdherit te Kryetarit te Bashkise Nr. 404 date 07.06.2024 me Prot 3669/1 *“Per ngritjen e grupit të punes per verifikimin e problematikes dhe disiplinimin e parkingjeve publike ne Nj.A. Temal bashkelidhur këtij projekt vendimi.*

Juriste: Dorina Lekaj
Drejtoria e Planifikimit Territorit, Kadastres dhe Investimeve Publike





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
Njësia Administrative Temal

Ni. 3669 Prot
Dt. 07.06.24

X.
Nr 44 Prot

07.06
Vau Dejës, 07.06.2024

Lënda: Kërkesë për ndërhyrje

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës
Z. Kristian Shkreli

Drejtorisë së Planifikimit të Territorit
Znj. Ana Shurdha

Të nderuar,

Njësia Administrative Temal, gjatë sezonit turistik, po përballlet me problematikat e krijuara, lidhur me parkimin e automjeteve rrugore, vecanerisht , segmenti që lidh Lagjen Gushtë me Kalatën, lidhur me parkimin e mjeteve, të personave që vizitojnë Komanin, pasi nuk kemi një vendparkimi publik , të miratuar nga bashkia,

Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj:

1. Të bëhet zhvendosja e traut nga hyrja e urës në fund të saj sipas hartës bashkëngjitur.
2. Disiplinimin e parkimit egzistues.
3. Zgjerimin e hapësirës publike për ta përshtatur për parkim shtes.
4. Të disiplinohet një parkim publik për banorët rezident (pa pagesë).

Me respekt, Administratori!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI**

Nr. 366S/Prot

Vau Dejës, më 07.06.2024

URDHËR

Nr. 404, datë 07.06.2024

**“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR, VERIFIKIMIN, E PROBLEMATIKËS
DHE DISIPLINIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE NË NJ.A. TEMAL**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; ligji nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”; ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” të ndryshuar; ligjin nr.107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; ligji nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimin nr.408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar; VKM nr.1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirave publike” i ndryshuar; VKM nr.433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” i ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Verifikimin në terren të problematikës së adresuar nga Nj.A Temal, disiplinimin e parkingjeve publike në fshatin Koman Nj.A Temal (konkretisht segmenti që lidh lagjen Gushtë me Kalatën).
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri grupi i punës si më poshte:
 - Z.Gjovalin Pacaj – Përgjegjës i Sektorit të Investimeve Publike (Kryetar grupi)
 - Z.Martin Luka – Kryeinspektor i IMT
 - Z. Armand Velaj – Përgjegjës i Sektorit të GIS dhe Kadastrës
 - Z.Xhezualdo Zefi – Specialist i Sektorit të Investimeve Publike
 - Z.Gjergj Dodani – Kryeinspektor i Policisë Bashkiake

3. Verifikimi të shoqërohet me një relacion të detajuar, hartografik dhe të gjitha të dhënat e tjera teknike, sipas legjislacionit në fuqi për parkingjet publike i cili të bëhet me dije Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.
4. Verifikimi në terren do bëhet me datën 10.06.2024
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni



Konceptoi:

Specialiste/Sektor Ligjor

Ersilda Preka

Miratoi:

Drejtore/Sektor Ligjor

Marinela Deda